



INSTITUCIONET E PERKOHSHME VETE QEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

PËR : Qeverinë e Kosovës

NGA : MASHT

Nr : /13/ 2002/

DATA: 04.09.2002

LËNDA: Pagat e mesimdhënësve

Rritja e pagave për mesimdhënësit

Është më se e ditur e rrogat e mesimdhënësve në Kosovë janë të ulëta në krahasim me nëpunësit tjerë të departamenteve tjera të Qeverisë. Në krahasim me vendet fqinjë, mesimdhënësi Kosovarë merr shumë më pak të holla se kolegu i tij. Rrogat e ulëta të mesimdhënësve Kosovarë kanë disa implikime. Atom und të përmblihdhën në këtë mënyrë :

- 1. Mesimdhënja është punë me orar të plotë. Mesimdhënësit duhet të përgatiten për mësim , prandaj nuk kanë mundësi të punojnë ndonji punë tjetër me honorar.**
- 2. Duke marrë parasysh koston e lartë të jetesës e cila është ngritur disa here, për mesimdhënësit dhe familjet e tyre është vështirë të mbijetojnë me paga aq të ulëta.**
- 3. Pagat e mesimdhënësve të cilat janë fiksuar në Janar të vitit 2000 , fare nuk kanë ndryshuar. Në anën tjetër për nëpunës të kategorive tjera , pagat janë rritur, si psh. Në postë, polici etj.**

4. Për shkak të pagave të vogla, mesimdhënësit e sidomos mesimdhënësit e Arsimit të lartë, mund të shkojnë në vendet tjera duke shkaktuar kështu mjaftë dëm Arsimit vendor.
5. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë ka hyrë në procesin e reformave me qëllim të përmirësimit të Arsimit në Kosovë. Duke e ditur se mesimdhënësit janë implementuesit kryesor të reformës, me pagat e tyre aq të ulëta, ata do të jenë të demotivuar për punë.

Propozim:

Përmirësimi i nivelit të pagave për mesimdhënësit nuk është përgjegjësi e Ministrisë të Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë. Edhe Ministrisë tjera në potë njëjtën mënyrë përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga kjo Ministri. Prandaj, me qëllim që komuniteti mesimdhënës t'ju sugerahet një pozitë e respektuar, propozohet që sa më parë të organizohet një takim mes Këshillit Ekonomik Fiskal dhe Ministrisë të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Këshilli i lartëpërmendur duhet ta analizojë gjendjen, ta gjejë burimin, të paraqesë udhëzimet dhe strategjinë për tejkalimin e kësaj krize shumë vjeqare. Në të njëjtën kohë grupi i punës i eksperteve për qeshtje teknike duhet të takohet dhe të përfshijë të gjitha detajet kryesore të rekomanduara nga grupi i eksperteve të këshillit. Grupi i eksperteve për qeshtje teknike mund të përbehet nga ministri i financave, ministri i Arsimit, ministri i shërbimeve Publike dhe përfaqësuesi i bankës botërore.

Rexhep Osmani

Minister i MASHT